



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 1440 Prot.

Tiranë, më 03.04 2026

## K Ë R K E S Ë

**KËRKUES:** Jo më pak se 35 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/4 e deputetëve të Kuvendit)

**OBJEKTI:** Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.

**BAZA LIGJORE:** Neni 77 i Kushtetutës së Shqipërisë;  
Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë;  
Ligji nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit", i ndryshuar.

**DREJTUAR:** **Z. Niko PELESHI**  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) administron infrastrukturën digjitale kritike të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet platformës e-Albania, AKSHI menaxhon të dhënat identifikuese, certifikatat e lindjes, të dhënat tatimore, regjistrin civil dhe pronat e të gjithë qytetarëve shqiptarë. Si institucion i vënë drejtpërdrejt nën autoritetin e Kryeministrit, AKSHI përfaqëson nyjen qendrore të sovranitetit digjital të shtetit, funksionimi korrekt i të cilit është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.

Më 16 dhjetor 2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) nisi, sipas asaj që raportojnë mediat, një nga operacionet më të mëdha në historinë e kësaj prokurorie ndaj infrastrukturës digjitale shtetërore. Pas një hetimi dyvjeçar mbi 12

procedurash prokurimi me vlera të konsiderueshme, Gjykata e Posaçme (GJKKO) urdhëroi masa sigurie ndaj tetë shtetasve. Akuzat përfshijnë: "konkurrencë e paligjshme nëpërmjet dhunës", "heqje e paligjshme e lirisë", "shkelje e barazisë në tenderë", "grupi i strukturuar kriminal" dhe "pastrimi i produkteve të veprës penale".<sup>1</sup>

Në qendër të hetimit ndodhen:

- **Mirlinda Karçanaj:** Drejtoresha e Përgjithshme e AKSHI-t për mbi 12 vjet (tetor 2013 – shkurt 2026), e emëruar nga Kryeministri Rama menjëherë pas marrjes së pushtetit në 2013. Masa: arrest shtëpiak, dhënë nga GJKKO më 18 dhjetor 2025.
- **Hava Delibashi:** Zëvendësdrejtoresha e AKSHI-t. Masa: arrest shtëpiak.
- **Ergys Agasi:** Biznesmen, i akuzuar si organizator i grupit kriminal. Masa: arrest më burg, por në arrati.
- **Ermal Beqiraj:** Pronar i kompanisë "Soft & Solution", fitues i shumicës së tenderave të AKSHI-t. Masa: arrest më burg, në arrati.
- **Erion Ismaili:** Zëvendësdrejtori i Policisë së Tiranës. Masa: pezullim nga detyra.
- Tre administratorë të kompanive fituese të tenderave të AKSHI-t.

Sipas dosjes së SPAK, skema kriminale raportohet të funksiononte në tre shtresa:

**Shtresa 1: Kontroll i brendshëm mbi tenderat:** Drejtoresha Karçanaj, bazuar në pamjet e siguruara nga kamera të fshehura të instaluar në zyrën e Ergys Agasit, zhvillonte takime të përsëritura me Agasin dhe Beqirajn ku diskutoheshin drejtpërdrejt kriteret e tenderave dhe procedurat e prokurimit. Në bisedat e përgjuara dëgjohet shprehja: "projekti bën 2 milion, ne do ta bëjmë 4", e cila, sipas SPAK, nënkupton rritjen artificiale të fondit limit të kontratave me para publike.<sup>2</sup>

**Shtresa 2: Kompania fiktive për larjen e parave:** Ergys Agasi themeloi kompaninë "EA Solutions" më 15 shtator 2023 me kapital të tij prej 1,000 lekësh (10 euro). Brenda më pak se katër muajsh, kjo kompani deklaroi të ardhura prej 242.4 milionë lekësh dhe fitim prej 232.1 milionë lekësh, me raport fitim/të ardhura prej 95.7%, shifra që Prokuroria i ka cilësuar të pamundura për një aktivitet real. Analiza e librave kontabël doli në përfundimin se "EA Solutions" nuk ekziston si entitet fizik real", por ka grumbulluar deri tani afërsisht 8 milionë euro.<sup>3</sup>

**Shtresa 3: Dhuna dhe pengmarrja si mjete kërcënimi:** Më 12 gusht 2025, biznesmeni Gerond Meçe, i cili kishte bërë ankesa të shumta ndaj kriterëve diskriminues të tenderave të AKSHI-t, u rrëmbye nga individë të pidentifikuar që u paraqitën si oficerë të BKH-së. Ai u çua në Kilometrin 26 të rrugës Tiranë-Elbasan, ku u kërcënua dhe u detyrua të tërhiqej nga proceset e ankimimit. Akuza për "heqje të paligjshme të lirisë" mbart një dënim prej 10 deri në

<sup>1</sup> <https://balkaninsight.com/2025/12/16/eight-accused-in-albania-of-rigging-information-agency-tenders/>

<sup>2</sup> <https://www.tiranatimes.com/secret-tenders-violence-and-kidnappings-him-the-staggering-profits-of-aksh-contractors/>

<sup>3</sup> <https://www.tiranatimes.com/secret-tenders-violence-and-kidnappings-him-the-staggering-profits-of-aksh-contractors/>

20 vite burg. Ky është rasti i parë në historinë e Shqipërisë ku procedurat e prokurimit publik trajtohen nga prokuroria si operacion i krimit të organizuar.<sup>4</sup>

Dosja e SPAK evidenton se Viola Agasi, motra e shtetasit Ergys Agasit, ka qenë e punësuar pranë AKSHI-t në pozicionin e Drejtoreshës Juridike dhe si anëtare e grupeve të punës për procedurat e tenderave. Drejtoria juridike e AKSHI-t kontrollon: interpretimin ligjor të kontratave, verifikimin e procedurave të prokurimit, dhe "vulosjen" ligjore të vendimeve institucionale. Prania e familjarit të drejtpërdrejtë të personit të akuzuar për organizim të grupit kriminal në pozicionin kyç juridik të institucionit, përbën në vetvete një shkelje serioze të ligjit për konfliktin e interesit dhe kërkon sqarime institucionale.<sup>5</sup>

Më 21 dhjetor 2025, gjatë natës, nga kantina e banesës së Ergys Agasit, ku agjentë të BKH-së kishin bllokuar më parë një koleksion verash pa pullë fiskale të vlerësuar në disa milionë euro, u zhvendos e gjithë sasia në mënyrë të fshehtë. Në të njëjtin rast, serveri i kamerave të sigurisë të vilës u zhduk. Sipas Prokurorisë së Tiranës, kushëriri i Ergys Agasit, Eno Agasi, dyshohet të ketë kryer këto veprime me qëllim fshirjen e gjurmëve të personave që kishin frekuentuar banesën. Për Eno Agasin është vendosur masa "arrest më burg" në mungesë dhe ai vijon të jetë në kërkim.<sup>6</sup>

Fakti që një person në kërkim nga SPAK kishte mundësi të lëvizte lirisht, të aksesonte pronën e sekuestruar dhe të fshinte prova kritike, ngre pyetje serioze mbi funksionimin e strukturave shtetërore të zbatimit të ligjit dhe mbi infiltrimin e mundshëm të këtyre strukturave nga interesa kriminale.

Rasti më i fundit i AKSHI-t nuk duhet vlerësuar i izoluar. Në korrik 2022, AKSHI, sipas deklaratave zyrtare, është sulmuar rëndë nga grupi i hakerave iranian "Homeland Justice", i atribuar nga FBI, CISA, Microsoft etj., si operacion i sponsorizuar nga Ministria e Inteligjencës Iraniane. Për pasojë të kësaj ngjarje, të cilën vendi ynë e cilësoi si "agresion shtetëror", Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Iranin. NATO i dënoi zyrtarisht sulmet, kurse SHBA sanksionoi Ministrinë e Inteligjencës Iraniane.<sup>7</sup>

Në këtë kontekst, fakti që AKSHI, institucioni i sulmuar, kishte në të njëjtën periudhë, por dhe në vijim, edhe, sipas SPAK, një grup të brendshëm kriminal që kontrollonte aksesin në mirëmbajtjen e serverëve shtetërorë, paraqet një rrezik të dyfishtë: si nga aktorë shtetërorë të huaj, ashtu edhe nga interesa kriminale të brendshme. Kompanitë e favorizuara nëpërmjet

<sup>4</sup> <https://balkaninsight.com/2025/12/16/eight-accused-in-albania-of-rigging-information-agency-tenders/>

<sup>5</sup> <https://shqiperia-etnike.com/kjo-eshte-viola-agasi-motra-e-ergys-agasit-drejtoreshje-juridike-ne-aksh/>

<sup>6</sup> <https://shqiptaria.com/hajm/prokuroria-e-tiranes-shpall-ne-kerkim-kusheririn-e-ergys-agasit-hoqi-veren-miliona-euro-nga-kantina-malli-ishte-bllokuar-nga-dogana-pasi-ishte-kontrabande>

<sup>7</sup> [https://www.nato.int/cps/en/natohq/official\\_texts\\_207156.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_207156.htm)

tenderave të manipuluar kishin akses fizik dhe digjital në serverët e institucioneve më të rëndësishme të shtetit, akses i cili jo vetëm që nuk ka qenë i denoncuar, por duket se është garantuar nga korrupsioni institucional.

Gjithashtu, në periudha të tjera, ka pasur një sërë rrjedhjesh të mëdha të të dhënave të cilat kanë prekur qindra mijëra qytetarë shqiptarë:

- Prill 2021: 910,000 qytetarë të Tiranës panë se të dhënat elektorale, preferencat politike dhe informacione konfidenciale, përfshirë numrat e identifikimit personal, rrodhën në prag të zgjedhjeve, dhe ishin të aksesuara nga Partia Socialiste, nëpërmjet asaj që mediatikisht u quajt skema e patronazhimit.<sup>8</sup>
- Dhjetor 2021: 637,138 qytetarë panë se si u bënë publike pagat, ID-të dhe të dhënat e punësisimit, në një dokument Microsoft Excel, të qarkulluar në programin e komunikimit EhatsApp.<sup>9</sup>
- Tetor 2022: MEMEX, sistemi kriminal i Policisë së Shtetit, u hakerrua, duke ekspozuar 105,000 skedarë hetimesh.<sup>10</sup>
- Në nëntor 2022: 600 oficerë të inteligjencës shqiptare të ekspozuar me emra, e-maile dhe numra telefoni.<sup>11</sup>
- Në mars 2026: Sipas raportimeve mediatike që i referohen burimeve të FBI-së, të dhënat e shqiptarëve janë në shitje, ku ato të e-Albania mund të kushtojnë 0.05 BTC (bitkoin, rreth 3,000 €), ndërsa databaza e kartave ID të shqiptarëve kushton 0.01 BTC (bitkoin, rreth 600 Euro).<sup>12</sup>

Ekspertë të sigurisë dhe përfaqësues parlamentarë kanë cilësuar vazhdimisht këto raste si kërcënime të hapura për sigurinë kombëtare. Nuk janë raste të izoluara, por të përsëritura vazhdimisht, pa asnjë masë të marrë. Parlamenti i Republikës së Shqipërisë do të duhet të veprojë brenda juridiksionit të vet. Rastet e përmendura paraqesin tri kërcënime të ndërthurura: (i) qytetarë të ekspozuar në mënyrë të përsëritur nëpërmjet rrjedhjeve të të dhënave, (ii) infrastruktura kritike shtetërore e aksesuar nga kompani të lidhura me interesa kriminale, dhe (iii) Shqipëria si një pikë potenciale cenueshmërie në arkitekturën e sigurisë së NATO-s<sup>13</sup>.

<sup>8</sup> <https://www.zeramerikes.com/a/5849951.html>

<sup>9</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/skandal-me-te-dhenat-private-pagat-e-nbi-637-shqiptareve-dalin-ne-public-nisin-hetimet-ndaj-tatimeve-dhe-sigurimeve-shoqerore>

<sup>10</sup> [balkanweb.com/deklarata-e-for-te-ekspertit-te-kriminalistikes-1-7-giga-informacion-kriminal-i-sistemit-memex-u-publikua-sot-nga-hackerat/](https://balkanweb.com/deklarata-e-for-te-ekspertit-te-kriminalistikes-1-7-giga-informacion-kriminal-i-sistemit-memex-u-publikua-sot-nga-hackerat/)

<sup>11</sup> [balkanweb.com/hakerat-dekonspirojne-edhe-shish-nxjerrin-listen-me-emra-dhe-adresat-e-emailit-te-rreth-600-punonjese/](https://balkanweb.com/hakerat-dekonspirojne-edhe-shish-nxjerrin-listen-me-emra-dhe-adresat-e-emailit-te-rreth-600-punonjese/)

<sup>12</sup> <https://www.scri.net/politike/874847/skandali-i-hakerimit-agjenti-i-infiltruar-i-fbi-se-bleu-me-bitcoin-databasen-e-albania-dhe-te-kartave-id-te-shqiptareve/>

<sup>13</sup> <https://albeu.com/lajme/bim-kapja-e-akshi-nga-interesa-kriminale-rrezikon-sigurine-kombetare/845379/>

Hetimi penal i SPAK-ut, sado i rëndësishëm, ka në fokus përgjegjësinë penale individuale. Kontrolli parlamentar kërkon një dimension të ndryshëm: vlerësimin e dështimeve sistematike institucionale, rënien e mekanizmave të kontrollit që mundësojnë këto shkelje, dhe nxjerrjen e përgjegjësisë politike dhe institucionale të atyre që kanë emëruar, mbikëqyrur dhe mbrojtur drejtuesit e këtij institucioni përgjatë kësaj periudhe.

Gjykata Kushtetuese e cilëson si *"kompetencë kushtetuese"* të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta *"...institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushteti i pakicës parlamentare"*, që realizohet *"...në mënyrë të pavarur..."* dhe që është *"...i pakufizuar nga vullneti i shumicës"*. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila duke i pasur të kufizuara mjetet në dispozicion, mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.

Ushtrimi normal i veprimtarisë së Kuvendit kërkon ekzistencën e elementeve të domosdoshme që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për respektimin e ligjeve nga të gjitha organet e tjera të pushtetit publik dhe shtetasit, si dhe pajisjen e tij me mjetet e përshtatshme për realizimin e kontrollit mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe mbrojtjen e interesit publik.

Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar. Ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen e përfundimeve të caktuara, që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit e të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit.

Qëllimi i Komisionit Hetimor që kërkohet të krijohet mbi bazën e kësaj kërkesë, synon që të mbledhë informacione të hollësishme mbi funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), mbi ligjshmërinë e procedurave të prokurimit publik të zhvilluara prej saj, mbi nivelin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve dhe zyrtarëve shqiptar gjatë administrimit të infrastrukturës digjitale kritike të shtetit, nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, si dhe vlerësimin e nevojës për miratim, korrigjim, ndryshim të legjisllacionit, me qëllim që në të ardhmen të parandalohen pasojat negative që mund të vijnë për shtetin dhe qytetarët shqiptarë, nga shkeljet, parregullsitë, abuzimet dhe cenimet e sigurisë që lidhen me administrimin e sistemeve kritike digjitale, të dhënave personale dhe interesave të sigurisë kombëtare.

Objekti dhe qëllimi i ngritjes së këtij Komisioni Hetimor është në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore kushtetuese, për shkak se nuk sjell mbivendosje apo transferime të

kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta për organe të tjera, por synon njohjen dhe verifikimin në hollësi të të gjitha shkeljeve dhe parregullsive që lidhen me funksionimin e AKSHI-t, me administrimin e procedurave të prokurimit, me sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve, me qëllim që të kontrollohet ligjshmëria e veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shqiptare, të nxirren përgjegjësitë institucionale, si dhe të merren masa të përshtatshme për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe sigurisë në administrimin e infrastrukturës digjitale shtetërore, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare.

E drejta e Komisionit për kryerjen e hetimeve do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që mbulojnë deputetët, si përfaqësues të popullit dhe avokatë të interesit publik, për zbardhjen e plotë të kësaj çështjeje. Dobishmëria e këtij hetimi konsiston pikërisht në nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, duke ndihmuar në evidentimin e problemeve që lidhen me sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave, funksionimin e infrastrukturës digjitale kritike dhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës. Komisioni do të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, procesit të rregullt ligjor, prezumimit të pafajësisë, paanshmërisë dhe respektimit të jetës private.

Nëse i referohemi praktikës ndërkombëtare, natyra e çështjeve të hetuara nga komisionet hetimore ka qenë e një rëndësie substanciale apo parësore për publikun, me ndikim të veçantë në sigurinë kombëtare, në mbrojtjen e të dhënave, në funksionimin e institucioneve shtetërore dhe në marrëdhëniet ndërshtetërore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive institucionale dhe mospërsëritjen e fenomeneve të hetuara në të ardhmen. Në këtë drejtim, çështjet më të shumta kanë pasur për objekt administrimin e fondeve publike, funksionimin e infrastrukturave kritike, sigurinë kombëtare, marrëdhëniet ndërshtetërore, falimentimet e korporatave apo subjekteve të ndryshme private, të cilat kanë pasur një impakt në ekonominë e vendit, apo hetimin e fenomeneve kriminale.

Në rastin konkret, puna e Komisionit Hetimor nuk do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësive penale për personat që potencialisht mund të kenë kryer shkelje, pasi kjo është detyrë funksionale e organeve të drejtësisë. Komisioni Hetimor do të përqendrojë punën e tij në njohjen dhe verifikimin në thellësi të ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga zyrtarët shqiptarë gjatë funksionimit të AKSHI-t, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, gjatë administrimit të sistemeve kritike digjitale të shtetit, si dhe masave të marra ose të pamarra për garantimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve.

Nga ana tjetër, mbledhja e informacioneve të detajuara nga burimet relevante synon që në përputhje me realitetin e diktuar nga rrethanat, provat dhe të dhënat në dispozicion, të nxirren

përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korrigjimit të ligjeve të veçanta, me qëllim ofrimin e një mbrojtjeje të plotë ligjore dhe institucionale të parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës, sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në administrimin e infrastrukturës digjitale shtetërore, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës, sigurisë kombëtare dhe mbikëqyrjes parlamentare.

Kërkesa për ngritjen nga Kuvendi të një komisioni hetimor, përmbush tri kriteret kushtetuese si vijon:

(i) çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat Kuvendi është i autorizuar të marrë masa ligjore;

(ii) objekti i hetimit fokusohet në një çështje konkrete; dhe

(iii) ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e problematikave dhe dyshimeve të arsyeshme lidhur me ligjshmërinë e veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve dhe zyrtarëve shqiptarë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në administrimin e procedurave të prokurimit publik, në garantimin e sigurisë kibernetike, në mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve, si dhe në administrimin e infrastrukturës digjitale kritike të shtetit.

Kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligjshmërisë në Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për Vlerësimin e Sigurisë Kibernetike dhe Mbrojtjes së të Dhënave të Qytetarëve, si dhe për Analizimin e Rreziqeve për Sigurinë Kombëtare dhe Detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s, bazohet në nenin 77, pika 2 e Kushtetutës, i cili parashikon se: *“Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë.”*, si dhe neni 25 i Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se *“1. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesën e një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë një komision hetimi, për të shqyrtuar një çështje të veçantë. 2. Komisionet hetimore të Kuvendit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.”*

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, ne, një grup deputetësh, jo më pak se 1/4 e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, bazuar në nenin 77, pika 2 të Kushtetutës dhe nenin 25, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit,

### **KËRKOJMË:**

1. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligjshmërisë në Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për Vlerësimin e Sigurisë Kibernetike dhe Mbrojtjes së të Dhënave të Qytetarëve, si dhe për Analizimin e Rreziqeve për Sigurinë Kombëtare dhe Detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.

2. Komisioni ka për objekt të veprimtarisë së tij:

- i) Verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit që lidhen me bazat e të dhënave shtetërore, për periudhën 1 Janar 2014 – 31 Mars 2026;
- ii) Verifikimin nëse operatorë ekonomikë të kontraktuar kanë pasur akses në sistemet kritike digjitale dhe në çfarë kushtesh, përfshirë nëse është respektuar vettingu i sigurisë;
- iii) Analizimin e ndikimit të rrjedhjeve të të dhënave të viteve 2021–2022 në të drejtat e qytetarëve dhe në sigurinë kombëtare, si dhe vlerësimin e përgjegjësisë institucionale për këto incidente;
- iv) Nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale për emërimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e drejtuesve të AKSHI-t gjatë kësaj periudhe;
- v) Vlerësimin e respektimit të standardeve të NATO-s për mbrojtjen e infrastrukturës kritike digjitale dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë;
- vi) Propozimin e masave ligjore dhe institucionale të nevojshme për të garantuar në të ardhmen funksionimin e sigurt dhe transparent të infrastrukturës digjitale shtetërore.




3. Komisioni do të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe katër anëtarë i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe gjashtë anëtarë Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

4. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

Bashkëlidhur gjeni projektvendimin për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, kërkojmë vijimin e procedurës parlamentare për ngritjen e Komisionit Hetimor.

#### DEPUTETËT:

NR.	EMËR MBIEMËR	NËNSHKRIM
1.	<b>GAZHENT BARDHI</b>	
2.	<i>Abdulla Velshi</i>	
3.	<b>Ilirida Bollin</b>	

4.	Ajron Gjermanke	AMH
5.	Lub Muri	Mulle
6.	Derd Bylyk bashi	<del>Qatun</del>
7.	Tosha thul	<del>A</del>
8.	Jin Jorin	<del>Jos</del>
9.	Kastriot Birioli	<del>7.10.2026</del>
10.	Ramadan Likaj	Mulle
11.	Eno Botas	<del>Amir</del>
12.	BESART XHAPERI	<del>Amir</del>
13.	Lul Kosa	<del>Amir</del>
14.	Xhelal Mziu	<del>Amir</del>
15.	Bordh Spahiu	<del>Amir</del>
16.	Olga Hoti	<del>Amir</del>
17.	Alban Noka	<del>Amir</del>
18.	Zygar 'Isamb'	<del>Amir</del>

19.	Juan Boqi	
20.	Grete Zandele	
21.	Sury Celaj	
22.	Jovide Toloku	
23.	Ledina Atoli	
24.	Ava Abdija	
25.	Tedi Bluxni	
26.	Edmond Nealicosta	
27.	Edi Paloka	
28.	Maryota Lukan	
29.	Brunilda Haselin	
30.	Kidat Kaka	
31.	ERISA XHIXHO	
32.	Pratan Jeh	
33.	plawli Jimqi	

34.	Denisa Vata	
35.	BEVIND KELLIÇI	
36.	Geurt Shodukur	
37.	Josefine Topelli	
38.	Wangge Jule	
39.	Inu Zhupa	
40.	Madiona Sayje	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Projekt*

**VENDIM**

Nr. \_\_\_/2026

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT  
PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË NË FUNKSIONIMIN  
E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT  
(AKSHI) DHE PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

- I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.
- II. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:
- i) Verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit që lidhen me bazat e të dhënave shtetërore, për periudhën 1 Janar 2014 – 31 Mars 2026;
  - ii) Verifikimin nëse operatorë ekonomikë të kontraktuar kanë pasur akses në sistemet kritike digjitale dhe në çfarë kushtesh, përfshirë nëse është respektuar vetingu i sigurisë;
  - iii) Analizimin e ndikimit të rrjedhjeve të të dhënave të viteve 2021–2022 në të drejtat e qytetarëve dhe në sigurinë kombëtare, si dhe vlerësimin e përgjegjësisë institucionale për këto incidente;

- iv) Nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale për emërimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e drejtuesve të AKSHI-t gjatë kësaj periudhe;
- v) Vlerësimin e respektimit të standardeve të NATO-s për mbrojtjen e infrastrukturës kritike digjitale dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë;
- vi) Propozimin e masave ligjore dhe institucionale të nevojshme për të garantuar në të ardhmen funksionimin e sigurt dhe transparent të infrastrukturës digjitale shtetërore.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve, prezumimit të pafajësisë, paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.

IV. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, i paraqet Kuvendit në seancë plenare raportin përfundimtar, së bashku me rekomandimet në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, miratimet, ndryshimet apo korrigjimet ligjesh që ofrojnë mbrojtje dhe garanci për sigurinë kombëtare dhe të dhënat e qytetarëve.

V. Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe katër anëtarë i përkasin Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe gjashtë anëtarë Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Përbërja e Komisionit do të jetë si më poshtë:

1.		- Kryetar (PD)
2.		- Zëvendëskryetar (PS)
3.		- Anëtar (PD)
4.		- Anëtar (PD)
5.		- Anëtar (PD)
6.		- Anëtar (PD)
7.		- Anëtar (PS)
8.		- Anëtar (PS)
9.		- Anëtar (PS)
10.		- Anëtar (PS)
11.		- Anëtar (PS)

VI. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6-mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të kryetarit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VII. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Niko PELESHI**

Miratuar në datën \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026